



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 158/14
Nr. i fq. / Br. st. - 6 -
Data: / Datum 31.07.2014

VUSHTRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRI

PROCES VEBAL

Nga mbledhja e VI-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 26.06.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që në rend dite në "të ndryshme" të futen këto pika:

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërtimin e çeshmes në sheshin e qytetit.
- b. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- kërkoi sqarim nga kryetari i komunës lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore, e cila ka ardhur si material shtesë, pasi që në KPF është shqyrtuar Qarkorja Buxhetore, kurse Korniza Afatmesme Buxhetore nuk është shqyrtuar fare në KPF, edhe pse shqyrtimi i tillë është obligim ligjor.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - propozoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës për këtë mbledhje të KK-së, pasi që në ditët në vijim Ministria e Arsimit do të nxjerrë një udhëzim të ri administrativ, dhe i njëjti udhëzim do t'i kontribuojn plotësimit të tri rregulloreve në fjalë. Po ashtu tha se Komiteti Konsultativ për Arsrim duhet të japë kontributin e vet lidhur me këto tri rregullore. Në fund njoftoi se në kuadër të Kolegjiumit të Arsimit të Asociacionit të Kosovës ka ardhur një rregullore dhe duhet të bëhet harmonizimi i të gjitha rregulloreve shkollore në nivel të Kosovës.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime shtesë pse Korniza Afatmesme Buxhetore është proceduar për shqyrtim dhe aprovim direkt në mbledhjen e KK-së, pakaluar përmes KPF-së.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërtimin e çeshmes në sheshin e qytetit.**
- 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore.**
- 4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve (shqyrtimi i dytë).**
- 5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.24/14 për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi.**
- 6. Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal i veprimit për eficiencë të energjisë për periudhën 2014-2020 (shqyrtimi i parë).**
- 7. Shqyrtimi i Informatës mbi përgatitjen përfushatën e korrje-shirjeve (Drejtoria për Ekonomi).**
- 8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (Drejtoria për Inspektime).**
- 9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mungesën e shërbimeve të nevojshme për sektorët shëndetësorë: fizioterapi, dermatologji, dhe oftalmologji (DSHPS).**
- 10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me shërbimet publike: furnizim me ujë, pastrim të mbeturinave dhe ambientit (DSHP).**
- 11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me standarde e ndërtimit (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit).**
- 12. Të ndryshme.**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

- 2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërtimin e çeshmes në sheshin e qytetit.**

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Mustafa Genç, donator nga Turqia- njoftoi anëtarët e kuvendit të komunës lidhur me iniciativën e tij për financimin e ndërtimit të çeshmes në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet ndërtimi i çeshmes publike në sheshin e qytetit afér parkut dhe shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, gjegjësisht në hapësirën ku është rrënuar ish-objekti i njohur si "Shpëtia e Partizanit".

Mjetet financiare për ndërtimin e çeshmes publike të i bart qytetari në cilësinë e donatorit nga Ankaraja e Turqisë Mustafa Genç.

- 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore.**

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, paraqiti këto vërejtje: në faqen nr. 3 janë gjithsej 2.498 biznese të regjistruara, kurse në faqe nr. 5 për

vitin 2014 paraqiten 2.735 biznese të regjistrues; në faqe nr. 4 fjalia "në katër vitet e ardhshme..." të riformulohet me këtë përbajtje: "në tri vitet e fundit". Pastaj pyeti se a ka bërë komuna ndonjë analizë, pasi që në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2014-2016 thuhet se në vitin 2013 kanë qenë 3.133 biznese të regjistrues, ndërsa në vitin 2014 (sipas faqes nr. 5) janë 2.735 biznese të regjistrues dhe nga kjo nënkuptohej se brenda periudhës njëvjeçare në Komunën e Vushtrrisë janë shuar 398 biznese, prandaj ky është një tregues se diçka nuk është në rregull për klimën e të bërit biznes në Komunën e Vushtrrisë, për të cilën çështje kërkoi sqarim. Te faqe nr. 8, kërkoi që kur të hartohet draft-buxheti, të hiqet taksa në firmë e bizneseve; në faqe nr. 10 në fundin e fjalisë ku thuhet: "...si në vijim:" pastaj nuk paraqitet asgjë si vazhdimësi e këtij paragrafi; te faqja nr. 14 te pozicioni "bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural" tha se nuk janë paraparë subvencione fare, prandaj propozoi që gjatë hartimit të draft-buxhetit të parashihen subvencione për këtë pozicion. Në fund kërkoi sqarime pse ndodh kjo mospërputhje e shifrave në mes të faqes nr. 3 dhe nr. 5.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, tha se duhet të harmonizohen statistikat dhe shënimet, duke shtuar se në vitin e kaluar kuvendi i komunës miratoi Strategjinë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, prandaj kërkoi që disa çështje në mes këtyre dy dokumenteve të mos ndryshojnë shumë, pasi që ka dallime të mëdha në shumë sfera në mes të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014/2016 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2015/2017, siç janë: numri i banorëve në Komunën e Vushtrrisë, numri i biznese të regjistrues në komunë, numri i përgjithshëm i nxënësve. Pastaj lidhur me inkasimin e të hyrave vetanake, tha se drejtoria përkatëse duhet të paraqet një plan konkret me një dinamikë konkrete se si të veprohet me të hyrat e painkasuara, që vetëm të hyrat nga tatimi në pronë për vitet 2002-2013 janë mbi 2 milionë euro të painkasuara, prandaj propozoi mobilizim të të gjitha strukturave komunale për inkasimin e këtyre të hyrave.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me kornizën në fjalë, si dhe iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të KK-së lidhur me këtë kornizë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, paraqiti vërejtje që për vitet 2015-2017 nuk janë paraparë mjete për investime kapitale për arsim, duke shtuar se kjo është në kundërshtim edhe me priorititetet e përcaktuara në faqen nr. 16 në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015/2017.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me kornizën në fjalë, tha se është shqetësuese që për paga dhe mëditje, sidomos përfushën e arsimit mungojnë mjete të mjaftueshme. Po ashtu tha se për vitin e ardhshëm do të trefishohen subvencionet për bujqësi. Në fund tha se në vitet në vijim duhet të ndërtohen edhe tri shkolla në fshatrat: Maxhunaj, Pantinë dhe Druar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2015-2017 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 01/2015 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve (shqyrtimi i dytë).

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që të inspektohen më mirë barnatoret që kujdestarojnë, pasi që ka ankesa se disa barnatore nuk po e respektojnë orarin e kujdestarisë, duke shtuar se është e domosdoshme që të funksionojë kujdestaria, pasi që Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Shëndetësi kanë dështuar deri më tanë në furnizimin e emergjencës me barëra esenciale.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- kërkoi që të ketë shërbime njëzetekatërорëshe (24) të stomatologjisë në QKMF.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kërkoi të korrigohet te neni 1, pika 15.1 duke e riformular me fjalinë "...mund ta zhvillojnë veprimtarinë".

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë, si dhe lidhur me vërejtjet e anëtarëve të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kërkoi që neni 1, pika 15.3, fjalia "...që veprojnë në qytet" të zëvendësohet me fjalinë "...që veprojnë në komunë".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve, duke inkorporuar vërejtjet e arsyeshme të anëtarëve të KK-së.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.24/14 për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01 Nr. 24/14, dt. 30.01.2014, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1, nënpika 2 në vend të Besart Shaqiri, Komandant i stacionit policor, duhet të jetë: Komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri.

6. Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal i veprimit për eficiencë të energjisë për periudhën 2014-2020 (shqyrtimi i parë).

Shqipe Gashi, zyrtare në DSHP- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me draft-planin në fjalë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë për periudhën 2014-2020 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 26.06.2014 dhe zgjatë deri më 18.07.2014.

7. Shqyrtimi i Informatës mbi përgatitjen për fushatën e korrje-shirjeve (Drejtoria për Ekonomi).

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (Drejtoria për Inspektime).

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mungesën e shërbimeve të nevojshme për sektorët shëndetësorë: fizioterapi, dermatologji, dhe oftalmologji (DSHP).

10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me shërbimet publike: furnizim me ujë, pastrim të mbeturinave dhe ambientit (DSHP).

11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me standardet e ndërtimit (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit).

12. Të ndryshme.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - paraqiti disa shqetësime të qytetarëve siç janë: kanosja e rrezikut për qytetarët nga numri në rritje i qenve endacakë, të cilët bëdhen rrugëve të qytetit, sidomos në orët e vona të natës; hapësira brenda Kalasë thuhet se do t'i jepet në shfrytëzim ndonjë biznesmeni pér të ushtruar aktivitete gastronomike, duke shtuar se ka qenë si përfaqësues i shoqërisë civile dhe së bashku me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme kompetente janë pajtuar që hapësirës brenda Kalasë t'i jepet destinacion multifunksional dhe kurrsesi të mos ketë aktivitete të ndonjë restoranti apo kafiterie. Në vazhdim sqaroi se me hapësirë multifunksionale nënkuptohet që hapësira brenda Kalasë të shërbejë si hapësirë pér panaire të ndryshme, vend pér ekspozita artistike, artizanale, të shërbejë si teatro e hapur, kinema e hapur, të shërbejë pér ndonjë festival të filmit apo çfarëdo festivali tjetër, si dhe në hapësirën në fjalë të organizohet Takimi i Poeteshave Shqiptare. Në fund tha se Lëvizja Vetëvendosje është kundër shndërrimit të asaj hapësire në ndonjë restorant apo kafeteri që do të menaxhohej nga ndonjë biznesmen i afërt me pushtetin, duke paralajmëruar se nëse ndodh një gjë e tillë, atëherë Lëvizja Vetëvendosje në bashkëpunim me qytetarët do ta kundërshtojnë në të gjitha mënyrat.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar ndërtimit të trotuarit nga pompa e benzinës "Bajgora" e deri tek hekurudha, paraqiti shqetësimin e qytetarëve që punëkryesi i vendos skajoret në asfalt, duke e penguar komunikacionin.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- kërkoi nga Drejtoria pér Shëndetësi që të ofrohet shërbimi i protetikës mobile, pasi që në komunat tjera jepet protetika mobile pér kategori të veçanta me një shumë, e cila mbulon shpenzimin e punimit protetik, duke shtuar se një shërbim i tillë është i nevojshëm pér kategoritë e moshave të shtyra.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- paraqiti shqetësimin pér gjendjen e punëtorëve në fabrikën e "Llamkosit", duke shtuar se protestat e shpeshta të punëtorëve të fabrikës në fjalë, janë një tregues se ata kërkojnë dhe kanë nevojë pér ndihmë, prandaj kërkoi që kjo çështje të sensibilizohet nga kuvendi i komunës dhe nga kryetari i komunës. Pastaj tha se është shqetësuese që po ndodh vendosja nga KEDS-i i disa kutive nëpër shtyllat elektrike, pasi që po krijohet rrezik pér jetën e fëmijëve, si dhe pér familjet që banojnë afër këtyre shtyllave elektrike. Në fund tha se është e nevojshme që të merren masa, pasi që në pjesën e poshtme të qytetit, ku është prishur rruga qendrore dhe ku po zhvillohen punime, të ndërtohen disa rrugë pér kalimtarë, pasi që tek lumi "Podrança" janë krijuar gropat e shumta dhe po dalin zvarranik të ndryshëm.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit- ua uroj të gjithë besimtarëve të Fesë Islame Muajin e Shenjtë të Ramazanit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- iu bashkëngjit shqetësimit të M. Shabanit lidhur me vendosjen e kutive në shtyllat elektrike, kërkoi që urgjentisht të ndërmerren masa, pasi që punimet e bëra në aspektin teknik janë shumë të dobëta. Pastaj kërkoi që në rastin e asfaltimit të rrugëve, inspektorët duhet ta inspektojnë realizimin e projekteve nga punëmarrësi, duke përmendur një kablo elektrik tek Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina", e cila ka mbetur në ajër, në vend se të futej nën kubëza. Po ashtu kërkoi që të ndërmerret diçka, pasi që është degraduar shumë fusha në mes të fshatrave Sllatinë dhe Sumë.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit- paraqiti vërejtje pér punën e KEDS-it, duke përmendur rastin tek shoqata e martirëve dhe rastet sociale, pér të cilat qeveria iu paguan 500 kilovatë, kurse punëtorët e KEDS-it kanë këruar nga familjet e kategorive në fjalë që të paguajnë rrymën, akoma pa i shpenzuar 500 kilovatët e paguara nga qeveria.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar vërejtjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit, u përgjigj me sa vijon: qeveria komunale e ka trajtuar disa herë brenda vitit çështjen e qenve endacakë, duke shtuar se në vitin e kaluar janë ndarë 10.000 € pér trajtimin e qenve endacakë, duke njoftuar se Drejtoria pér Ekonomi,

Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e ka hartuar një paramasë, si dhe ia ka bërë propozimin Drejtorisë për Prokurim Publik pér ta shpallur një tender pér menaxhimin e qenve endacakë, pasi që me ligj është i ndaluar eliminimi i tyre; pér hapësirën brenda Kalasë, Komuna e Vushtrrisë është në pritje që ta merr nën menaxhim këtë hapësirë nga Ministria e Kulturës, duke premtuar se shfrytëzimi i saj do të bëhet në mënyrë shumë transparente; pér çështjen e trotuarit Bukosh-qytet, tha se është i njoftuar pér dobësitë që po tregohen në punimin e këtij trotuari, duke shtuar se ka intervenuar pér përmirësimin e punës; kërkesa pér ofrimin e shërbimeve mobile stomatologjike është shumë e arsyeshme; pér çështjen e fabrikës së "Llamkosit", tha se është duke i përcjell shumë shqetësimet dhe zhvillimet në këtë fabrikë, si dhe ka realizuar takime me autoritete të ndryshme pér tejkalimin e kësaj krize në fabrikë; premtoi se do të ketë interesim të veçantë pér ta kuptuar çështjen në detaje lidhur me vendosjen e kutive (njehësorëve) nga KEDS-i në shtyllat elektrike; pér punimet në rrugën "Skënderbeu", tha se rrugët tjera alternative janë në përfundim e sipër të punimeve; pér fushën e ndotur në fshatin Banjskë njoftoi se është përkujdesur personalisht pér të dhe përsëri do të trajtohet çështja e asaj fushe. Në fund ua uroj Muajin e Shenjtë të Ramazanit të gjithë besimtarëve të Fesë Islame.

Shpëtim Zhegrovë, kryesues i kuvendit – ua uroj Muajin e Shenjtë të Ramazanit të gjithë besimtarëve të Fesë Islame.

Mbledhja përfundoi në orën 11:48.

Procesmbajtësi

Kryesuesi i Kuvendit


Albanez Tahiraj



Lekturoi
Vlora Krasniqi